



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Buletini i Njoftimeve Publike

Nr.07

Datë 23.01.2023

Agjencia e Prokurimit Publik

Blv "Dëshmorët e Kombit"

Tel: + 355 4 2277510

e-mail: info.app@app.gov.al

<https://www.app.gov.al>



Të gjitha organizatat përfaqësuese sindikale në fushën e mësuesisë ftohen të shprehin interesin dhe të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm brenda datës 31 Janar 2023 pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni duhet të përmbajë dokumentet e parashikuara në pikën 3 të nenit 163 të Kodit të Punës, si më poshtë:

- Kërkesë për fillimin e bisedimeve;
- Vendimin e gjykatës dhe statutin e organizatës;
- Dokumentacionin me treguesit e nevojshëm për përfaqësueshmërinë e anëtarësisë sindikale.

Ky njoftim të publikohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar. Po ashtu, ky njoftim botohet në buletin e njoftimeve zyrtare në Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe Buletin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik.

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE **NJOFTIM**

Mbi shpalljen e thirrjes për aplikim në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 646, datë 5.10.2022 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private”

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019, “Për nxitjen e punësimit” dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 646, datë 5.10.2022 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private”, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive shpall thirrjen ku ftohen të gjithë institucionet e formimit profesional, publike apo private si dhe të gjithë punëkërkuarit apo punëkërkuarit e papunë të regjistruar në Zyrat e Punësimit, të marrin pjesë në këtë Program.

Afati i aplikimit në programin e formimit profesional me mbështetje financiare është i hapur gjatë gjithë vitit kalendarik.

Aplikimi do të bëhet në rrugë elektronike në portalin qeveritar e-Albania:

- a. Në shërbimin “Aplikim për programin e formimit profesional për institucionet publike apo private” për institucionet e formimit profesional, publike apo private;
- b. Në shërbimin “Aplikim për kursin e Formimit Profesional me mbështetje financiare” për punëkërkuarit apo punëkërkuarit e papunë.

TERMAT E REFERENCËS

PËR FUSHAT E VEPRIMTARISË, FINANCIMIN, KRITERET DHE PROCEDURAT E APLIKIMIT, SI DHE KRITERET DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL NËPËRMJET MBËSHTETJES FINANCIARE TË OFRUAR SIPAS PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT, PËR KURSET E FORMIMIT PROFESIONAL TË ORGANIZUARA NGA INSTITUCIONET E FORMIMIT PROFESIONAL, PUBLIKE APO PRIVATE

Në mbështetje të Vendimit nr. Nr. 646, datë 5.10.2022 të Këshillit të Ministrave

“Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private”

1. TË PËRGJITHSHME

1.1. Qëllimi i programit

Programi i formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare është një program formimi, i cili synon kualifikimin dhe rikualifikimin e punëkërkuarve dhe punëkërkuarve të papunë me qëllim përgatitjen dhe integrimin e shpejtë në tregun e punës.

Programi i formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) nëpërmjet strukturave të saj në bashkëpunim me institucionet e formimit profesional, publike apo private.

1.2. Tiparet kryesore dhe zbatimi i programit

Programi i formimit profesional do të jetë intensiv me shtrirje kohore 3 deri në 12 muaj. Ky program do të mbështetet në infrastrukturën fizike dhe teknike të përshtatshme përmes një programi formimi në fushën e programimit. Do të shoqërohet me mentorim nga instruktorë të specializuar dhe do të mundësojë njohuri teorike dhe praktike mbi fushën e përcaktuar.

1.3. Fusha e zbatimit të programit

Fusha e zbatimit të programit është miratuar nga Ministria përgjegjëse dhe do të jetë si vijon: kodim, programim kompjuterik, zhvillim aplikacionesh, robotikë, elektronikë, shkencë të dhënash, siguri kibernetike, inteligjencë artificiale, testim softuerësh, dizajn softuerësh, dizajn faqesh web-i, dizajn i përvojës së përdoruesit, dizajn i ndërfaqes së përdoruesit, mësimi makinerik/automatik, realitet i shtuar, realitet virtual ose algoritmet kompjuterike apo fusha të ngjashme të tjera.

2. KRITERET DHE PROCEDURAT E APLIKIMIT

2.1. Kriteret e aplikimit për e institucionet e formimit profesional publike apo private

Kërkesa dhe dokumentacioni për pjesëmarrjen e institucioneve të interesuara të formimit profesional në skemën e mbështetjes financiare dorëzohen nëpërmjet portalit e-Albania.

Institucioni aplikues i formimit profesional duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

- të ketë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë kombëtare ose ndërkombëtare në ofrimin e kurseve të formimit profesional;
- të mos jetë në proces falimentimi ose likuidimi;
- të mos ketë detyrime tatimore të pashlyera;

- d. të ketë të paktën 100 kursantë të trajnuar dhe të certifikuar gjatë veprimtarisë së mëparshme të tij;
- e. të zotërojë një faqe interneti aktive, ku të pasqyrojë të gjithë informacionin e nevojshëm për kursantët, si katalogun e kurseve të ofruara, mënyrën e aplikimit në kurs, datat dhe afatet e zhvillimit të kursit, kurrikulën e kompetencave të kursit dhe, sipas rastit, informacionin për skemën e mbështetjes financiare për kursantët dhe tarifat përkatëse;
- f. të ketë lidhur marrëveshje me operatorë tregu për ofrimin e praktikave të punës për kursantët e certifikuar;
- g. të ofrojë këshillim karriere;
- h. në rastin e personit fizik, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale. Për personat juridikë, të mos jetë i dënuar organi administrativ, aksionarët ose ortakët.

Dokumentet që ngarkohen në portalin e-Albania janë, si vijon:

- a. certifikata e regjistrimit të kërkuesit pranë organit shtetëror kompetent;
- b. dëshmia për gjendjen gjyqësore të anëtarëve të organit administrativ, aksionarit ose ortakut, të personit që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda personit juridik;
- c. dëshmia që kërkuesi nuk është në proces falimentimi ose likuidimi;
- d. vërtetimi i lëshuar nga institucioni tatimor përgjegjës për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
- e. pasqyrat financiare të audituara në 3 (tre) vjetëve të fundit;
- f. plani i detajuar i biznesit për 3 (tre) vjet;
- g. deklarimi për numrin maksimal të kursantëve, që kërkohet të mbështeten nëpërmjet skemës së mbështetjes financiare;
- h. marrëveshja e partneritetit me entet shqiptare apo të huaja për mbështetjen e kurseve të formimit profesional, nëse ka;
- i. lista e instruktorëve dhe mënyra e angazhimit të tyre në kursin e formimit profesional, që do të ofrohet në kuadër të skemës së mbështetjes financiare;
- j. dëshmitë për kualifikimet/certifikimet/ përvojën e çdo instruktori të angazhuar në kursin e formimit profesional, që do të përfshihet në mbështetjen financiare;
- k. planin mësimor për çdo kurs, për të cilin kërkohet pranim në skemën e mbështetjes;
- l. kriteret e pranim, të kursantëve në çdo kurs të formimit profesional, që do të jetë pjesë e mbështetjes financiare;
- m. listën e mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e kursantëve, si: provime, sfida teknike apo projekte;
- n. mekanizmi i ngritur gjatë ose pas përfundimit të kursit të formimit profesional, për këshillimin e karrierës dhe marrëveshjet për ndërlidhjen e kursantëve me operatorët e tregut të punës;
- o. modeli i certifikatës që individi merr pas përfundimit me sukses të kursit të formimit profesional;
- p. vetëdeklarimi për numrin e kursantëve të certifikuar gjatë 3 (tre) vjetëve të fundit dhe për shkallën/nivelin e punësimit;
- q. tarifa e zbatueshme për secilin kurs, që do të ofrohet në kuadër të skemës së mbështetjes financiare.

Dokumentet e përcaktuara, në momentin e ngarkimit në portalin e Albania duhet të jenë:

- a. në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtarë, në origjinal ose të njësuar me origjinalin;

- b. në rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj dhe të legalizuara ose të pajisura me vulë apostile, në përputhje me legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.

2.2.Kriteret e aplikimit për punëkërkuesin:

Për të përfituar nga ky program personat e interesuar duhet të jenë të regjistruar si punëkërkues apo punëkërkues të papunë në databasën e shërbimeve të punësimit.

2.3.Procedura e Aplikimit

- a. Institucionet e formimit profesional publike apo private duhet të aplikojnë për pjesëmarrjen në program, në rrugë elektronike në portalin qeveritar e-Albania në shërbimin “Aplikim për programin e formimit profesional për institucionet publike apo private”;
- b. Aplikimi i saktë përbëhet nga formulari i aplikimit bashkëlidhur me dokumentacionin e kërkuar në pikën 2.1 të specifikuar më sipër;
- c. Komisioni i Vlerësimit, i ngritur në AKPA vlerëson aplikimet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesave për pjesëmarrje;
- d. Lista e institucioneve të formimit profesional fituese, publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të internetit të AKPA-s. Gjithashtu, kjo listë vihet në dispozicion të aplikantëve punëkërkues dhe punëkërkues të papunë në portalin qeveritar e-Albania;
- e. Punëkërkuesit apo punëkërkuesit e papunë aplikojnë nëpërmjet Formularit të Aplikimit në portalin qeveritar e-Albania në shërbimin “Aplikim për kursin e Formimit Profesional me mbështetje financiare për institucionet publike apo private”, për programin e dëshiruar duke përzgjedhur institucionin e preferuar të formimit profesional dhe dy institucione alternative;
- f. Drejtoria Rajonale e Punësimit bën verifikimin e përmbushjes së kriterëve për të gjithë aplikantët, kujdeset për listimin e tyre sipas preferencave dhe i referon tek institucionet publike apo private të formimit profesional, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e aplikimit të punëkërkuesit/ punëkërkuesit të papunë;
- g. Institucionet e formimit profesional publike apo private, përzgjedhin pjesëmarrësit në bazë të kriterëve të pranimit të tyre, brenda 10 ditëve kalendarike nga paraqitja e listës;
- h. Institucionet e formimit profesional publike dhe private kanë detyrimin të njoftojnë Drejtorinë Rajonale të Punësimit për pjesëmarrësit e përzgjedhur për secilin kurs.

2.4.Afatet e aplikimit

Afati për fillimin e aplikimeve nga institucionet e formimit profesional publike apo private është data e publikimit të kësaj thirrje në Buletinin e Njoftimeve Publike të APP dhe do të jetë e hapur deri në fund të vitit kalendarik.

3. KRITERET DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Institucionet e formimit profesional publike dhe private kualifikohen për të përfituar mbështetje financiare, nëse kërkesa e dorëzuar prej tyre vlerësohet me të paktën 70 pikë për metodologjinë e mëposhtme të vlerësimit:

- a. Kapacitetet për ofrimin e kursit të formimit profesional, sipas kriterëve të përgjithshme dhe teknike, ku përfshihet përvoja, infrastruktura fizike, teknike, platforma dhe licencat, si dhe kapacitetet e stafit trajnues vlerësohen deri në 60 pikë;
- b. Plani i biznesit vlerësohet deri në 20 pikë;

- c. Mekanizmi i ngritur për këshillimin e karrierës dhe marrëveshjet për ndërlidhjen e kursantëve me tregun e punës vlerësohen deri në 20 pikë.

Vendimi për kualifikimin ose jo të kërkesave për mbështetje financiare bazohet në mesataren e pikëzimit individual të çdo kërkesë nga të tre anëtarët e Komisionit të Vlerësimit.

4. FINANCIMI I PROGRAMIT

4.1 Mbështetja e përfituesve

- a. Pjesëmarrësit punëkërkues të papunë të regjistruar, financohen në masën 100%, por në asnjë rast më të lartë se 300,000 (treqind mijë) lekë të kostos së kursit të formimit profesional.
- b. Çdo pjesëmarrës punëkërkues financohet në vlerën 50% të kostos së kursit të formimit profesional, por në asnjë rast më të lartë se 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
- c. Për personat me aftësi të kufizuara, institucionit privat të formimit profesional i financohen elementet e përshtatjes së arsyeshme, për sa i përket programeve të veçanta të trajnimit, kurrikulës së përshtatur në përputhje me shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar, përgatitjen e instruktorëve për të ofruar trajnim të posaçëm për këtë kategori, deri në shumën 200,000 (dyqind mijë) lekë pas dorëzimit të kërkesës nga ana e tij.

4.2 Mënyra e financimit

Disbursimi i financimit të institucionit të formimit profesional publik apo privat, bëhet nga struktura rajonale e punësimit.